



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.42/2018
Prishtinë, më, 03.10.2018, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari-Lila, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Liburn Aliu, Glauk Konjufca, dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Vatra Qehaja - LVV.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Formimi i Grupit për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it;**
- 3. Informatë lidhur me shkeljet e dispozitave të Ligjit për komunikime elektronike, nga anëtari i Bordit të ARKEP-it;**
- 4. Të ndryshme**

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Formimi i Grupit për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it;

Kryetarja, tha se në bazë të Ligjit për energji elektrike, Komisioni për zhvillim ekonomik, është komision përkatës për energji, dhe duhet të bëjë zgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm për t'ia dërguar Kuvendit së paku dy kandidatë për një pozitë. Ajo tha se është takuar edhe me kompaninë e kontraktuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe , të cilët në bazë të një marrëveshjeje që e ka Kuvendi i Kosovës për përzgjedhjen e pozitave të larta, më sugjeruan që ne të formojmë një grup ose panel prej tre anëtareve nga Komisioni, saktësisht udhëheqja e Komisionit, kryetarja, dhe dy zëvendëskryetarët, sepse jemi pozitë- opozitë dhe minoritet. Lista e kandidatëve për anëtarë të Bordit të KOSTT-it, është prej 33 vetave, dhe besoj se do të kemi rastin të bëjmë një përzgjedhje të mirë. Ky grup do të raportojë në Komision, pastaj për kandidatët e përzgjedhur do të vendos seanca.

Dardan Sejdiu, tha se heq dorë që të jetë në panel kurse për këtë vend e propozoi deputeten znj. Hykmete Bajrami, e cila vjen nga partia opozitare më e madhe në Kuvend.

Hykmete Bajrami, tha se nuk kemi kompetencë që ne si komision të bëjmë një përzgjedhje të tillë të anëtarëve të Bordit të KOSTT-it. Ne mund të angazhojmë ekspertë që të na ofrojnë ndihmë në këtë proces, sepse ne nuk jemi ekspertë për fushën që specifike, ndërsa, edhe komisioni e ka buxhetin e vet të cilin mund ta shfrytëzoj për këtë arsye.

Kryetarja, theksoi se kjo çështje është e përcaktuar me ligj, dhe ne do të veprojmë sipas kompetencave tona të përcaktuara me ligj, kurse edhe përzgjedhja do të bëhet në bazë të kriterëve të vendosura me ligj.

Mimoza Kusari – Lila, tha se ligji përcakton kriteret, andaj kjo lehtëson punë. Por, pajtohem edhe me propozimin e deputetes Hykmete Bajrami, që të angazhohet eksperti i jashtëm që të ndihmojë në procesin e përzgjedhjes së më të mirëve në pikëpamje profesionale.

Muharrem Nitaj, theksoi se ne si komision kemi kompetenca ligjore në përzgjedhjen e kandidatëve, por pasi ka praktika të tilla edhe ne mund të shfrytëzojmë angazhimin e ndonjë eksperti të jashtëm.

Memli Krasniqi, tha se deri te kjo situatë kemi ardhur për shkak të ndryshimeve ligjore, ku tani kandidatët për anëtarë të bordit i propozon komisioni dhe jo Qeveria. Sa i përket dilemave për ndikime politike, tani është mundësia shumë më e vogël, kur kemi parasysh ngjyrimet politike në komision si dhe monitorimin e procesit nga partnerët me Ambasadën britanike. Duke pasur parasysh numrin e kandidatëve, besoj se do të kemi mundësinë për përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë.

Pas debatit, Komisioni njëzëri, nxori këtë:

VENDIM

- 1. Formohet Grupi për zgjedhjen e Bordit të KOSTT-it;*
- 2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Sala Berisha Shala, kryesuese, Adem Hoxha dhe Hykmete Bajrami;*
- 3. Ngarkohet stafi mbështetës i Komisionit që ti ofroj grupit të punës të gjitha kushtet e parapara më Ligj dhe Rregullore të Kuvendit.*

3. Informatë lidhur me shkeljet e dispozitave të Ligjit për komunikime elektronike, nga anëtari i Bordit të ARKEP-it

Kryetarja, theksoi se edhe ne mbledhjen e kaluar është diskutuar kjo pikë, po ashtu, bëri të ditur se deputeti Liburn Aliu, pas shqyrtimit të materialeve, është dakorduar me shkarkimin e këtij anëtari të bordit. Materialin e keni marr javën e kaluar, ku janë theksuar të gjitha arsyet e shkarkimit të këtij anëtari të Bordit të ARKEP-it, sepse me veprimet e tij ka rënë ndesh me Ligjin.

Pas debatit, Komisioni me 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të shkarkohet z. Shqiprim Pula, nga Bordi i Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

4. Të ndryshme.
Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA